



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Gjiçanit
Opština Gnjilane
Municipality of Gjiçan
Gjiçan Belediyesi

Në mbështetje të nenit 37 paragrafi 1.6 , të nenin 38 paragrafi 1.4 dhe në nenin 46 paragrafi 4 të Statutit të Komunës së Gjiçanit 01. nr. 16-126211 dt. 06.11.2014, e në bazë të Rekomandimit të Komitetit për Shërbime Publike, Banim, Mbrojtje dhe Shpëtim 01.Nr.60/2015 të datës 26.06.2015, Kuvendi i Komunës së Gjiçanit në mbledhjen e mbajtur me 29.06.2015, merr:

V E N D I M

Për ndalimin e qarkullimit të automjeteve motorike në “Bulevardin e Pavarësisë”

1. Me këtë vendim ndalohet e qarkullimit i automjeteve motorike në kohën prej orës **19:00-23:30**, në “Bulevardin e Pavarësisë”, rruga prej udhëkryqit të rrugës “Medllin Olbrajt (rruga e Prishtinës) e deri në përfundim të parkut të qytetit (në drejtim të Stacionit të autobusëve).
2. Ndalimi qarkullimit të automjeteve motorike si në pikën 1.1 të këtij vendimi bëhet për të krijuar kushte të mira të lëvizjes së lirë të qytetarëve (shëtitore) në këtë pjesë dhe do të vlej nga data **01.07.2015-31.08.2015**.
3. Zbatimin e këtij Vendimi e bënë Kryetari i Komunës dhe Drejtorja për Shërbime Publike, Infrastrukturë dhe Banim në koordinim me Policinë e Kosovës, përderisa për monitorim të zbatimit do të kujdeset Kryesuesja e KK-Gjiçan.
4. Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MAPL-së dhe publikimit në gjuhët zyrtare në ueb fagen e Komunës,

01.Nr. 016-60815
Gjiçan, më 29.06.2015

Kryesuesja e Kuvendit,

Valentina Bunjaku-Rexhepi